



# BASHKIA SHKODËR

## “Informacion mbi bashkëpunimin e Bashkisë Shkodër me Organizatat e Shoqërisë Civile”

Nëntor, 2019

## HYRJE

Bashkia e Shkodrës ka një traditë të bashkëpunimit të vazhdueshëm me organizatat e shoqërisë civile. Një nga objektivat e Bashkisë Shkodër është partneriteti i ngushtë me shoqërinë civile, organizatat jo-fitimprurese, biznesin privat dhe biznesin social në veçanti për ofrimin e shërbimeve shoqërore për shtresat në nevojë. Bashkia e Shkodrës ka nisur një iniciativë koordinimi me organizatat për të implementuar iniciativa të përbashkëta të shtrira në të gjithë territorin e saj. Nëpërmjet këtij hapi pozitiv, bashkia ka ndërmarrë lidhshpimin për të koordinuar më mirë dhe me më tepër efektivitet burimet e disponueshme dhe në të njëjtën kohë për t'u siguruar se janë adresuar nevojat dhe prioritetet e komunitetit, duke shmangur njëkohësisht mbivendosjet. Procesi është akoma në vazhdimësi e sipër dhe synon hartimin e planeve të përbashkëta dhe ndarjen e përgjegjësisive në përputhje me objektivat strategjike dhe synimet kryesore.

Bashkia Shkodër ka arritur në marrëveshje bashkëpunimi me organizata ndërkombëtare, kombëtare dhe vendore, me qëllim ofrimin e shërbimeve në territorin e saj, përmirësimin e cilësisë së jetesës së komunitetit. Ndër shërbimet që ofrohen në bashkëpunim me organizatat janë; fuqizimi socio-ekonomik i familjeve në vështirësi ekonomike, shërbimet alternative të kujdestarisë familjare, mbështetja dhe integrimi i personave me aftësi ndryshe, deinstitutionalizimi, ri-integrimi i fëmijëve migrantë apo të rikthyer nga emigracioni, përfshirja sociale për romët dhe egjiptianët, si një shtysë e mirë për integrimin e këtij komuniteti, mbrojtja dhe trajtimi i viktimave të dhunës në familje, buxhetimi me pjesëmarrje dhe përfshirja e qasjes gjinore në buxhetin e bashkisë së Shkodrës, promovimi i territorit të bashkisë Shkodër, promovimin e produktit territorial. etj.

Për bashkëpunimin me shoqërinë civile, dhe koordinimin e këtij bashkëpunimi, Bashkia Shkodër ka ngritur dhe ka vënë në funksion tryezën konsultative me shoqërinë civile. Kjo tryezë zhvillon një sërë takimesh brenda një viti, dhe synimi i kësaj tryeze është konsolidimi i bashkëpunimit, vlerësimi i nevojave të komunitetit, ofrimi i shërbimeve në përputhje me nevojat e territorit dhe ndarja e shërbimeve sipas nevojave.

Gjithashtu me qëllim realizimin e objektivave zhvillimore të Bashkisë Shkodër, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile, Bashkia Shkodër është shpallur fituese në thirrjen e lançar nga Programi Rajonal për Demokraci Lokale në Ballkanin Perëndimor (ReLOaD). Ky Program është një iniciativë rajonale tre-vjeçare e financuar me fonde të Bashkimit Europian nga Instrumentet e Asistencës së Para-Anëtarësimit (IPA) dhe zbatohet nga UNDP në gjashtë vende të Ballkanit Perëndimor. Qëllimi i projektit është që të forcojë demokracinë pjesëmarrëse dhe procesin e integritimit në BE në vendet e Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet fuqizimit të shoqërisë civile duke mundësuar pjesëmarrjen e saj aktive në vendimmarrje si dhe nxitjen dhe krijimin e një mjedisi ligjor dhe financiar inkurajues për shoqërinë civile.

Referuar kushteve të Programit ReLOaD, Bashkia Shkodër merr përsipër përgjegjësinë e bashkëfinancimit në masën 22% të vlerës së projekti ReLOaD. Bashkëfinancimi është programuar i ndarë në dy vite buxhetore për periudhën e kohëzgjatjes së projektit 2018 – 2020. Bashkia Shkodër angazhohet që gjatë periudhës kohore 2018 – 2020 të organizojë tre thirrje publike, nga të cilat, dy të parat do të financohen nga shuma e alokuar e grantit (fondet e PNUD dhe 22% bashkëfinancimi i bashkisë) dhe thirrja e fundit do të financohet nga fondet e vetë bashkisë. Thirrjet për projekt propozime do të realizohen në zbatim të VKB nr. 69, datë 30.10.2017 për “Miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit ndërmjet Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara dhe Bashkisë Shkodër” si dhe miratimin e metodologjisë LOD për financimin e organizatave të shoqërisë civile”. Në total fondi i vënë në dispozicion për OSHC-të është 123.000 \$.

Për vitin 2018 u realizua thirrja e parë për projekt propozime. Në këtë thirrje aplikuan 20 OSHC nga të cilat 3 u shpallen fitues. Në mbështetje të marrëveshjes financiare Prot nr. 331/30 datë 17/05/2018, kontributi i Bashkisë Shkodër ishte 1 831 022 lekë.

Për vitin 2019 u realizua thirrje e dytë për projekt propozime. Në këtë thirrje aplikuan 12 OSHC nga të cilat 3 u shpallen fitues. Në mbështetje të marrëveshjes financiare Prot nr. 1729/25, datë 17.06.2019, kontributi i Bashkisë Shkodër ishte 1 267 543 lekë.

Për vitin 2020, thirrja e fundit do të financohet nga fondet e vetë bashkisë.

### **Nxitja dhe mbështetja e bashkëpunimit me organizatat e shoqërisë civile në fushën e zhvillimit ekonomik dhe turizmit.**

#### **a) BID Shkodra**

Bashkia Shkodër në bashkëpunim me AADF (Fondacioni i Zhvillimit Shqiptaro –Amerikan) ka zbatuar projektin “BID Shkodra” përgjatë rrugëve “28 Nëntori” dhe “13 Dhjetori”. Zgjerimi ka konsistuar në shtrirjen e aktivitetit të saj edhe të zonës së rrugës këmbësore “Kolë Idromeno”. Tashmë zona e përmirësimit të biznesit (BID) përbëhet nga rr. 13 Dhjetori – rr. 28 Nëntori – rr. Kolë Idromeno. Gjatë vitit 2019 është realizuar bashkëpunimi me zonën e përmirësimit të biznesit BID Shkodër. Bashkia Shkodër ka mbështetur me mjete financiare nëpërmjet transferimit tek BID. Nga ky bashkëpunim është dyfishuar numri i bizneseve nga 60 në rreth 120.

#### **b) Shoqata e Artizaneve**

Bashkia Shkodër ka prioritet mbështetjen dhe zhvillimin e biznesit vendor në kuadër të promovimit dhe zhvillimit të artizanatit dhe produkteve territoriale. Në këtë kuadër është lidhur marrëveshja me Shoqatën e Artizanëve e cila ka për qellim:



- Mbështetjen në organizimin e panairëve, ekspozitave dhe aktiviteteve promovuese sipas kalendarit të miratuar për vitin 2019 të Shoqatës së Artizanëve të Punimeve Artistike të Shqipërisë.
- Përfundimin nga tarifat e përkohshme të Shoqatës së Artizanëve të Punimeve Artistike të Shqipërisë për aktivitetet e organizuara apo në partneritet me Bashkinë Shkodër për promovimin e produktit territorial.

c) Këshilli Artistik Kulturor

Me vendim të Këshillit Bashkiak është ngritur Këshilli Artistik Kulturor, i përbërë nga 7 anëtarë. Përfaqësues të këtij Këshilli janë figura të shquara të artit, kulturës, sportit dhe organizatave të shoqërisë civile. Objekt i veprimtarisë së këtij Këshilli është:

- ✓ Vlerësimi dhe mbështetja e projekteve që nxisin politikën parësore të jetës kulturore, artistike, sportive dhe rinore që kanë impakt dhe zhvillim në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër.
- ✓ Vlerësimi dhe mbështetja e projekteve që prekin dhe aktivizojnë të gjitha grupmoshat si dhe grupet e interesit në jetën kulturore, artistike, sportive dhe rinore.
- ✓ Vlerësimi dhe mbështetja e projekteve që synojnë dhe afrojnë veprimtari elitare me aktivitete që synojnë pjesëmarrje aktive nga një publik i gjërë.

Projektet e parashikuara në buxhetin e Bashkisë në fushat kulturore, artistike, sportive dhe rinore janë të programuara për tu realizuar nga organizatat e shoqërisë civile. Bashkia Shkodër bën shpalljen për realizimin e aktiviteteve artistiko – kulturore. Ftesa është e hapur për të gjithë të interesuarit dhe publikohet në faqen e Bashkisë Shkodër. Pjesë e shpalljes është:

- Përshkrimi i projektit, qëllimi i tij;
- Kush ka të drejtën për të aplikuar, kush nuk mund të aplikojë;
- Koha e zhvillimit dhe e shpalljes së fituesit;
- Fondi limit;
- Kriteret e kërkuara;
- Specifika të veçanta (kur ka) për organizimin e aktivitetit;
- Dorëzimi i dokumentacionit;
- Formulari i aplikimit.

Bashkia Shkodër fton të gjithë të interesuarit për të sjellë projektet e tyre pranë Zyrës me Një Ndalesë të saj. Këshilli pas shqyrtimit të projekteve të dorëzuara bën vlerësimin dhe shpalljen e fituesit. I gjithë procesi publikohet në faqen e Bashkisë Shkodër.

d) Në fushën e turizmit

Organizimi i tryezave konsultative me universitetin, bizneset që operojnë në fushën e turizmit dhe organizatat e shoqërisë civile. Qellimi i këtyre takimeve është gjetja e rrugëve të bashkëpunimit ndërmjet bashkisë, universitetit, bizneseve dhe shoqërisë civile për zhvillimin e qëndrueshëm të turizmit në Bashkinë Shkodër. Takimet janë periodike, sipas një kalendari të përcaktuar dhe organizohen në formën e diskutimit mes aktoreve pjesëmarrës. Objekt diskutimi është mbarvajtja e sezonit turistik, problematikat e hasura në zhvillimin e sektorit të turizmit e më pas sugjerime se si mund të bëhet më mirë.

### Praktikat e mira të zbatuara nga bashkia në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile:

Tregues të zbatimit të veprimtarive	Treguesi (njësia matëse)		Shpjegime për treguesin e raportuar/ Përmbledhja e veprimtarive të zbatuara
	2018	2019	
Numri i dëgjesave publike me qytetarët të organizuar nga bashkia gjatë periudhës së përgatitjes së buxhetit.	21	21	Për një proces konsultimi sa më transparent është miratuar kalendari i hartimit të Programit Buxhetor Afat-Mesëm (PBA) dhe është përcaktuar veprimtaria e punës së Ekipeve të Menaxhimit të Programit (EMP). Këto ekipe janë angazhuar në organizimin e një sërë takimesh konsultative, në të gjitha njësitë administrative të Bashkisë Shkodër, me aktorë dhe palë të ndryshme të interesuara. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë edhe konsultime të tjera publike të cilat Bashkia ka ndërmarrë gjatë zhvillimit të aktiviteteve të saj.
Numri i kërkesave për informacion të ardhura nga OSHC-të.	63	20	Deri me datë 1 nëntor 2019 numri i kërkesave për informacion nga OSHC-të është 20.
Vlera (në total në lekë) i granteve të dhëna nga Bashkia për projekte në partneritet me OSHC.	20,895,022 lekë	17,556,600 lekë	Procedurat e ndjekura për dhënien e granteve nga Bashkia Shkodër ndaj organizatave të shoqërisë civile janë: transfertë, prokurim me vlerë të vogël dhe këshill artistik.



Numri i granteve të dhëna nga Bashkia për projekte të përbashkëta në partneritet me OSHC.	23	18	Këtu është përfshirë edhe bashkëfinancimi i bërë nga Bashkia Shkodër në kuadër të shpalljes së thirrjes së I-rë dhe II-të për projekt propozime, Programi Reload.
---	----	----	---

**Lista e projekteve kryesore të Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me OSHC-të:**

Nr	Titulli i projektit	Qellimi	Kohëzgjatja	OSHC bashkëpunuese
1	Projekti “Po të ardhmes”	Projekti “YES FUTURE” ka për qëllim të promovojë përfshirjen sociale të të rinjve dhe mbështetjen e pjesëmarrjes së tyre aktive në zhvillimin social të Bashkisë Shkodër, duke ju lehtësuar aksesin në shërbime të tilla si: edukimi formal dhe joformal, sipërmarrje, kulturë, informacioni dhe ICT, pavarësisht nga gjinia, raca, etnia, kultura, besimi, paaftësia, mosha dhe orientimi seksual.	30 muaj	Acli Ipsia në Shqipëri, Consulting and Development Partners
2	RELOAD (Regional Local Democracy Programme)	Programi ReLOaD synon të fuqizojë demokracitë pjesëmarrëse dhe procesin e integritit në BE në Ballkanin Perëndimor, duke e fuqizuar shoqërinë civile që të jetë pjesë e	36 muaj	UNDP Albania



		procese të vendimmarrjes si dhe duke kontribuar dhe mundësuar një mjedis ligjor dhe financiar inkurajues për shoqërinë civile.		
3	Agroturizëm Albania	Ka për qëllim mbështetjen e sipërmarresit me mjetet e nevojshme për të nxitur risinë, krijuar vende pune dhe ndërtuar ekonomi të zhvilluara.	24 muaj	CEED Albania
4	Projekti SEED (Support of Educational and Employment Development in Albania, Kosovo and Serbia)	Ka për qëllim që të përmirësojë qasjen e të rinjve dhe femrave në tregun e punës si dhe të kontribuojë në barazinë gjinore duke mbështetur zhvillimet pozitive sociale-ekonomike.	12 muaj	SEED 2
5	Ofrimi i shërbimeve të integruara në Qendrën Komunitare Multifunkcionale Nj.A Rrethina.	Shërbime sociale: parashoqërore dhe komunitare.	30 muaj	Word Vision
6	Përmirsimi i aksesit në një arsim cilësor parashkollor për fëmijët 0 - 8 vjec.	Ofrimi i shërbimeve cilësore për grupet sociale në rrezik.	24 muaj	ARSIS - Nisma për ndryshim shoqëror.
7	Mbështetja e fëmijëve Rom në edukimin e hershëm.	Ky projekt synon të nxisë modele pozitive të edukimit gjatë fëmijërisë së hershme.	12 muaj	ARSIS – Organizatë shoqërore e Përkrahjes së të rinjve.
8	Të gëzojmë dhe festojmë sëbashku.	Qëllimi i përgjithshëm i projektit:	24 muaj	Fondacioni "Hope for the World".



	Bashkëpunimi për përkujdesjen, mirërritjen dhe edukimin e fëmijëve të Shtëpisë së Fëmijës Shkollor, Shtëpisë së Foshnjës dhe Qendrës së Zhvillimit Shkodër.		
9	Fuqizimi ekonomik dhe egjiptian për romt dhe egjiptianët - një shtysë për përfshirje sociale"- ESERE	Fuqizimi social dhe ekonomik të komunitetit Rom & Egjiptian në Shqipëri duke stardartizuar qasje të reja inovative dhe të integruara në politik bërje dhe programim dhe të ofrojë modele të integruara të përfshirjes sociale në nivel lokal.	36 muaj UNDP Shqipëri.
10	Komuniteti i të ardhmes: Ndërhyrje të përfshira sociale dhe në tregun e punës për jetimët e Shkodres" AID 10950.	Ky projekt ka për qëllim favorizimin e përfshirjes sociale të fëmijëve dhe të rinjve jetimë të Bashkisë Shkodër, duke promovuar fuqizimin social dhe ekonomik të jetimëve, qasje të reja inovative dhe të integruara në politikë-bërje, duke ofruar modele të integruara të përfshirjes sociale në nivel lokal, me fokus Bashkinë Shkodër.	36 muaj Insituti i Paqes, Inovacionit dhe Zvillimit - ACLI.
11	Akses në shërbime shoqërore cilësore	Akses në shërbime shoqërore cilësore për garantimin e mbrojtjes, promovimin e të drejtave dhe mirëqënies së	36 muaj Terre des Hommes, misioni në Shqipëri dhe Kosove.





	fëmijëve dhe familjeve vulnerabël dhe në rrezik në qytetin e Shkodrës.		
<b>12</b>	Zgjerim i formave alternative në strukturat rezidenciale për fëmijët drejt deinstitucionalizimit të shërbimeve të përkujdesjes.	Mbështetje dhe promovim të të drejtave të fëmijëve për mbijetesë, mbrojtje e zhvillim: si dhe të drejtën për të jetuar e rritur në një ambjent familjar, qoftë familje biologjike apo kujdestare.	30 muaj Save the Children
<b>13</b>	Një qasje sektoriale për kontributin e shoqërisë civile në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian të Shqipërisë” Connect	Projekti ka për qëllim nxitjen e procesit të dialogut dhe ndërgjegjësimit të shoqërisë civile në lidhje me procesin e Integritimit Evropian.	12 muaj Instituti për Bashkëpunim dhe Zhvillim



**Lista e aktiviteteve kryesore të Bashkisë Shkodër në bashkëpunim me OSHC-të, viti 2019:**

Nr.	Përfituesi - OSHC-ja që ka zbatuar aktivitetin/fondin	Shërbimi	Procedura
1	BID Shkodra	Bashkëpunimi me Zonën e përmirësimit të biznesit (BID) në rrugën 13 Dhjetori dhe 28 Nentori.	Transfertë
2	Shpresë për të ardhmen	Panari Guri i Zi	Këshill artistik
3	Treva	Panari Rrethina	Këshill artistik
4	Treva	Panari Pult	Këshill artistik
5	The Door	Hapja e sezonit turistik Velipoje	Këshill artistik
6	The Door	Lojra popullore	Këshill artistik
7	The Door	Dita e bicikletave	Këshill artistik
8	Water Sports	Triathlon Labeat	Këshill artistik
9	Shoqata e Artizanëve dhe Zejtarëve të Shqipërisë.	Panairi i artizanatit në ditën ndërkombëtare të artizanatit.	Këshill artistik
10	Shoqata Kulturore "Rrok Jakaj"	Festivali i xhazit	Këshill artistik
11	Consulting and Development Partners	Dita e luleve	Këshill artistik
12	Shoqata Kulturore Artistike "Zef Jubani"	Karnevalet	Këshill artistik
13	Projekti "Shpresa"	Projekti "Shpresa"	Transfertë
14	Shoqata artistike kulturore "Promotor"	Festa e Muzikës	Këshill artistik
15	Shoqata kulturore Shpirti Artistik i Shkodrës	Festivali i 57 Kombëtar për fëmijë	Këshill artistik
16	Shprese për të ardhmen	Edhe unë e dua librin	Transfertë
17	Shoqata e Artizanëve dhe Zejtarëve të Shqipërisë.	Green Artisan - Artizanati në mbrojtjen e mjedisit.	Transfertë
18	The Door	Miq e rinj të Taraboshit Shkodër	Transfertë